



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare

Datë 03.08.2018

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale :

Shpall Konkurs Publik
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit:	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Titulli i punës:	Konsulent në Kabinetin e Ministrit
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta–(MSHV)
Raporton te:	Shefit të Kabinetit të Ministrit
Koeficienti :	paga 577.50 €
Kohëzgjatja e kontratës:	6 muaj
Orari i punës:	I plotë
Numri i ekzekutuesve:	1 (një)
Vendi:	Kabineti i Ministrit / MPMS

Përshkrimi i detyrave të punës :

- Ndhmon Ministrin dhe kabinetin e Ministrit në zhvillimin e politikave të punësimit, politikave të pensioneve dhe ato sociale ;
- Ndhmon shefin e kabinetit në përcjelljen e detyrave përmbyllëse brenda zyrës;
- Mbështetë aktivitetet e përditshme në kabinetin e Ministrit;
- I përgjigjet njëkohësisht shefit të kabinetit dhe Ministrit;
- Kryen detyra të tjera që janë në interes të shërbimit, sipas rekomandimeve nga kabinetin e Ministrit.

Shkathtësitë e kërkuara: *(Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)*

Diplomë universitare;

5 vjetë përvojë pune

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs : Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin : Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Procedurat e konkurrimit : Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave: Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Divizioni për Burime Njerëzore, Sheshi “Zahir Pajaziti” ndërtesa e re e MPMS-së në Prishtinë, aplikacioni mund të shkarkohet nga ueb-faqe <http://mpms-gov.net/>

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni Divizionin për Burime Njerëzore në numër telefoni 038 212-886, prej orës 8:00 – 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 7(shtatë) ditë kalendarike, që nga dita e publikimit, nga data: **03.08.2018** deri më **09.08.2018**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 2 ditësh; ndërsa aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin arsimor, dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës, për të cilin konkurrohet.

Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen!

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mirëpret aplikacionet nga të dy gjinitë nga të gjitha komunitetet.